



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.03.2023

**MBLEDHJA Nr. 18,**  
**Datë 04.04.2023, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 04.04.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 18 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 20.03.2023, 23.03.2023 dhe 27.03.2023
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.09.2018
4. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW
6. Mbi licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier
7. Mbi licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
8. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s 58, datë 31.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kW”
9. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M&K Energy Trading CO” sh.p.k.

10. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**